REPUBLIKA E SHQIPËRISË
UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"
GJIROKASTËR
ADMINISTRATORI

Nr. 188 prot.                                                  Gjirokastër, më 05.02.2020

Lënda : Raporti Vjetor Financiar për vitin 2019.

**BORDIT TË ADMINISTRIMIT**

**KËTU**

Në zbatim të Ligjit Nr.80/2015 datë 22.07.2015, "Për arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë" neni 32, të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 "Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë ", të ligjit nr.99/2018 datë 03.12.2018 "Për buxhetin e vitit 2019", të Udhëzimit nr.2, datë 06.02.2012 "Për proçedurat standarte të zbatimit të buxhetit",të ndryshuar, udhëzimit të përbashkët Nr.20 datë 20.09.2019 të MASR dhe M.F.E "Për skemën dhe zbatimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor"; VKM-së Nr.75 datë 12.02.2018 " Për miratimin e modeli të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit shkencor", të zbatimit të buxhetit, konform miratimeve, nga Bordi i Administrimit të Universitetit "Eqrem Cabej" , konfirmuar dhe nga Dega e Thesarit Gjirokastër, është përgatitur për miratim veprimtaria financiare e institucionit nëpërmjet Raporti Vjetor Financiar për vitin 2019 për si më poshtë:

**Aktiviteti financiar për vitin 2019 është bazuar në dy burime financimi si më poshtë :**

1-Financimin nga Buxheti i Shtetit në vlerën prej **194.971.503** lekë.

2-Financimin nga të ardhurat e Institucionit në vlerën prej **111.539.020** lekë.

Financimit nga buxheti i shtetit prej **194.791.503** lekë i akorduar në fillim të vitit 2019 iu shtua në vazhdim edhe vlera prej **10.984.623** lekë fonde të trashëguaranë zbatim VKM-së Nr.75 datë 12.02.2018 " Për miratimin e modelit të financimit të institucioneve publike të arsimit të lartë dhe kërkimit

shkencor", si dhe vlera prej **1.912.127** lekë fonde për rimbursim të tarifave të studentëve si rrjedhim i ndryshimit të VKM Nr 288 datë 21.05.2018 me VKM Nr 778 datë 26.12.2018 .Gjithashtu në vitin 2019 është shtuar financimi edhe me fondin prej 16.142.890 lekë për dy projekte me objekti "Blerje pajisje e instrumenta Laboratorike" për Laboratorin e Arkeologjisë dhe Restaurimit në vlerën **12.052.886** ( dymbëdhjet milion e pesëdhjet e dy mijë e tetëqindë e tetëdhjetë e gjashtë) lekë si dhe "Blerje pajisje e instrumenta Laboratorike"në vlerën prej 4.090.000 (katër milion e nëntëdhjetë mijë) lekë për projektin kërkimor për aplikimin e ICT në mësimdhënien e ICT, shtesë kjo pas aplikimit të Njësive Bazë pranë AKSHI-it. Në vazhdim ky fond u pakësua me 8.500.000 lekë, për projektin e Arkeologjisë duke mbetur vlera e fondit për këtë projekt 3.552.886 lekë dhe për të dy projektet vlera prej **7.642.886** lekë.

Planifikimi dhe realizimi i shpenzimeve me fonde nga buxheti i shtetit të ndarë sipas zërave të jepen në tabelën e mëposhtme:

| Nr. | Emërtesa | Viti 2019 | | |
|---|---|---|---|---|
| | | Plani<br>Viti 2019 | Realizimi<br>Viti 2019 | % e Realizimit me planin fillestar |
| 1 | Fondi i pagave | 153.629.344 | 153.475.803 | 99.9% |
| 2 | Sigurime shoqerore | 30.500.000 | 29.219.177 | 96% |
| 3 | Shpenzime operative | 9.667.694 | 3.563.237 | 37% |
| 4 | Bursa e transferime | 14.071.215 | 9.497.120 | 67% |
| 5 | Investime | 7.642.886 | 6.897.240 | 90% |
| | **Gjithsej shpenzime** | **215.511.139** | **202.652.577** | **93%** |

**Nga Buxheti i Shtetit për 2019 është përballuar:**

1- pagesa e rrogave të punonjësve akademikë dhe administrativ, sipas strukturës organike të miratuar.si dhe nga fondi i pagave gjatë vitit 2019 janë dhënë shpërblime për raste të veçanta në vlerën prej 297.186 lekë.Ky fond është realizuar në masën 99.9%.

2- pagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore nga punëdhënësi në masën 96% .

Fondet nga Buxheti i Shtetit të akorduar për vitin 2019, ka qënë në limitin për të përballuar pagesat e planifikuara në fillim të vitit,për pagat e punonjësve për dhjetë muaj ,sigurime shoqërore e shëndetësore si edhe bursat,kurse për zërin e shpenzimeve operative është realizuar në masën 37% sepse është hera e parë qe fondet nga buxheti i shtetit trashëgohen në zbatim të VKM-së Nr.75 datë 12.02.2018 ,për këtë arsye nuk mund të planifikohej për shpenzime operative në momentin e hartimit të buxhetit në fillim të vitit 2019.



REPUBLIKA E SHQIPËRISË - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

Sic shihet edhe nga tabela, realizimi i shpenzimeve me fonde nga Buxheti i Shtetit ka fonde të papërdorura tek:

1-Zëri paga në vlerën prej **153.537 lekë**

2-Zëri sigurime shoqërore në vlerën prej **1.280.823 lekë**

2- Zëri transferime korrente jashtë shtetit në vlerën prej **257.621 lekë,**

3- Zëri bursa për studentët në vlerën prej **4.574.093** lekë.
4-Investime (blerje paisje laboratorike për laboratorin e arkeologjisë dhe laboratorin e ICT nga projektet e financuara nga AKSHI ),në vlerën prej **745.646** lekë
5- Zëri shpenzimet operative në vlerën prej **5.846.842** lekë .
Në total trashëgohen për vitin 2020 sipas zërave të mësipërm ,nga fondet e buxhetit vlera prej **12.858.562** lekë.

Për financimin e shpenzimeve nga të ardhurat dytësore për vitin 2019, jemi bazuar

**1.në krijimin e të ardhurave dytësore për Universitetin"Eqrem Çabej" Gjirokastër në vitin 2019 të cilat janë krijuar sipas tabelës së mëposhtëme:**

| Nr | Lloji i të ardhurave | Viti 2019 |
|---|---|---|
| 1 | Tarifa Shkollimi | *30.943.530* |
| 2 | Vërtetime e te tjera | *1.749.438* |
| 3 | Tarife regjistrimi e te tjera (kredite te pashlyera) | *10.500* |
| | ***SHUMA*** | ***32.703.468*** |

Sic shihet edhe nga tabela e mësipërme për vitin 2019, të ardhurat janë realizuar në vlerën **32.703.468** lekë gjithsej, nivel ky më i ulëti i viteve të fundit ,si rrjedhim i ndryshimit të VKM Nr 288 datë 21.05.2018 me VKM Nr 778 datë 26.12.2018 ,por edhe i numrit të studentëve .

Duke analizuar të ardhurat e realizuara të Universitetit gjatë viteve të fundit ato janë ulur, në një masë të konsiderueshme, pavarësisht nga hapja e programeve të studimit "Master Profesional" dhe "Master Shkencor", sepse pothuajse në të gjitha programet e studimit të Universitetit,

-numri i studentëve të regjistruar ka ardhur në ulje përkatësisht :

për vitin akademik 2015-2016 1770 studentë

për vitin akademik 2016-2017 1626 studentë

për vitin akademik 2017-2018 1454 studentë

për vitin akademik 2018-2019 1521 studentë

megjithëse duket një rritje e lehtë e numrit të studentëve nga viti akademik 2017-2018 në vitin akademik 2018-2019 , por ka studentë që rregjistrohen por nuk frekuentojnë procesin mësimor e për rrjedhojë nuk paguajnë as tarifën e shkollimit,duke ndikuar në mënyrë të drejtpërdrejtë në të ardhurat e Institucionit .

-një pjesë e tarifës së shkollimit të studentëve është arkëtuar që në muajt nëntor–dhjetor 2018, -

- trajtimi i një numri të madh studentësh , të cilët vijnë kryesisht nga shtresa sociale në nevojë, me prindër invalid apo edhe vetë studentët me PAK, të përndjekur politik, etj dhe për rrjedhojë nuk e paguajnë ose e paguajnë pjesërisht tarifën e shkollimit sipas sistemit të studimit përkatës.

Për vitin akademik 2017- 2018 janë përjashtuar nga tarifa 120 studentë të bachelorit dhe 12 studentë të masterit në vlerën 2.940.000 lekë.

Për vitin akademik 2018-2019 janë përjashtuar 175 studentë nga të cikët 148 studentë në ciklin e parë të studimeve dhe 27 studentë në ciklin e dytë të studimeve në vlerë prej 2.835.100 lekë

Në vitet e fundit realizimi i të ardhurave është si më poshtë:

Viti 2015: 66.753.400 lekë

Viti 2016 62.799.799 lekë

Viti 2017 49.688.000 lekë

Viti 2018 40.870.305 lekë

Viti 2019 32.703.468 lekë

Në vitin 2019 realizimi i të ardhurave është në masën 32.703.468 lekë

Nga viti 2018 janë trashëguar 105.638.630.04 lekë të ardhura

Gjatë vitit 2019 janë përdorur 75.256.545.27 lekë nga të ardhurat

Për vitin 2020 trashëgohen 63.085.552.77 lekë të ardhura .

**2. në të ardhurat e trashëguara në vite .**

Financimi nga të ardhurat e Institucionit prej **111.539.020** lekë e ndarë sipas zërave të shpenzimeve jepet në tabelën e mëposhtme:

REPUBLIKA E SHQIPERISE - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTER

| Nr. | Emërtesa e shpenzimeve | Viti 2019 | | |
|---|---|---|---|---|
| | | Limiti i përdorimit | Realizimi | % e Realizimit me planin fillestar |
| 1 | Fondi i pagave | 46.485.601 | 40.717.436 | 88 % |
| 2 | Shpenzime Operative | 33.768.289 | 26.107.530 | 77 % |
| 3 | Investime | 29.858.330 | 8.361.379 | 28 % |
| 4 | Studime projektime | 1.426.800 | 70.200 | 5% |
| **5** | **Studime e kërkime(projekte )** | 3.400.000 | **0** | |
| | **Shuma** | **114.939.020** | **75.256.545** | **65%** |

Plani i limitit të përdorimit nga të ardhurat dytësore për **vitin 2019** në total është **114.939.020** lekë, nga i cili është realizuar në vlerën **75.256.545** lekë, përfshirë ndryshimet e herëpasherëshme (të cilat janë miratuar rast pas rasti nga Bordi i Administrimit) ku të detajuar sipas artikujve të shpenzimeve i analizojmë më poshtë:

**I- Financimi nga të ardhurat dytësore në zërin e pagave** ka përfshirë pagesëne rrogave të punonjësve për muajin tetor , nëntor ,pagesën e orëve të pedagogëve të ftuar ,orët jashtë kohës normale të punës për punonjësit mbështetës , orët suplementare .Me fondin e mësipërm të pagave janë mbuluar të gjitha shpenzimet sipas shkresave të ardhura nga Njësitë kryesore (Dekanatet) dheNjësitë Bazë ( Departamentet) për të gjithë punonjësit efektiv dhe ata të jashtëm për vitin 2019.Ka një realizim tek ky zë, prej 88%

**II-Financimi nga të ardhurat dytësore për shpenzimet operative:**

Shpenzimet operative për vitin 2019 janë mbështetur kryesisht nga të ardhurat e institucionit. Fondi i planifikuar për shpenzimet operative është në masën **33.768.289** lekë lekë 'Gjatë vitit janë bërë rialokime të ndryshme, brenda limitit të përdorimit.Këto rialokime pasi janë dërguar për miratim në BA-it , , ku janë njoftuar edhe Zyra e Prokurimeve pranë MASR-së ,Dega e Thesarit Gjirokastër. Shpenzimet sipas zërave të detajuara janë dhënë tek tabela e Regjistrit të Realizimit të Prokurimeve. Në tabelë është dhënë planifikimi dhe realizimi sipas zërave me gjitha ndryshimet përkatëse të miratuara gjatë vitit nga Bordi i Administrimit. Për zërin e



REPUBLIKA E SHQIPERISE - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTER

shpenzimeve operative sic shihet financimi nga të ardhurat përbën bazën e shpenzimeve ,për arsye të fondeve të limituara nga Buxheti i Shtetit , i cili nuk mjaftonte të planifikonim në zërin e shpenzimeve operative .Nga të ardhurat u financuan shpenzimet për kontratat e prokuruara, për shpenzimet me blerje me vlerë të vogël,për tarifat shtetërore fikse që institucioni paguan çdo muaj ,si edhe për investimet.Shpenzimeve të planifikuara nga të ardhurat e institucionit, si edhe nga Buxheti i Shtetit u është dhënë rëndësi e veçantë përdorimi me efektivitet të tyre, me qëllim realizimin e shpenzimeve më të domosdoshme dhe mbajten e një fondi rezervë ,pasi me mbylljen e vitit buxhetor ato trashëgohen për vitin pasardhës..

Realizimi i shpenzimeve operative është në vlerën 65 % .

Shpenzimet sipas zërave janë të detajuar si nga buxheti ashtu edhe nga të ardhurat në tabelën e realizimit të shpenzimeve si më poshtë:



REPUBLIKA E SHQIPERISE - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

| | Objekti i prokurimit | Fondi limit | |
|---|---|---|---|
| | | Plan | Fakt |
| 1 | Roje civile (kontrate shtesee amer | 2,560,971 | 1,783,497 |
| 2 | Karburant | 4,200,000 | 4,199,990 |
| 3 | Sherbime te printimit dhe publikim | 960,000 | 674,400 |
| 4 | Kancaleri, boje fotokopje,printeri | 2,453,860 | 2,195,890 |
| 5 | Materiale pastrimi | 360,000 | 273,528 |
| 6 | Mirembajtje kompjuterash | 240,000 | 231,600 |
| 7 | Mirembajtje dhe riparim fotokopj | 240,000 | 226,800 |
| 8 | Materiale elektrike,hidraulike dhe | 300,000 | 239,880 |
| 9 | Ilace dhe materiale per laboratore | 120,000 | 67,320 |
| 10 | Mirembajtje mjet transporti (dy m | 480,000 | 442,800 |
| 11 | Sigurimi i detyrueshem i mjeteve a | 192,000 | 175,977 |
| 12 | Abonim per sherbim interneti | 149,620 | 149,620 |
| 13 | Mirembajtje te aparateve kondicio | 240,000 | 232,000 |
| 14 | Mirembajtje te kaldajave | 120,000 | 117,600 |
| 15 | Lyerje fasade | 120,000 | 119,880 |
| 16 | Pleh organik dhe inorganik | 48,000 | 40,000 |
| 17 | Sherbim qender zeri | 24,000 | 18,000 |
| 18 | Dezinfektim i ambjenteve | 48,000 | 47,520 |
| 19 | Bileta avioni | 716,915 | 716,915 |
| 20 | Mirembajtje taracave | 120,000 | 118,113 |
| 21 | Mirembajtje dhe riparime te banja | 120,000 | 95,160 |
| 22 | Sistemim i ambjentit te jashtem | 120,000 | 114,000 |
| 23 | Mirembajtje sistemi elektrik | 120,000 | 27,000 |
| 24 | Blerje materiale per ambjente te ja | 120,000 | - |
| | **Shuma** | **14,173,366** | **12,307,490** |

REPUBLIKA E SHQIPERISE - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" - GJIROKASTËR

| | | | |
|---|---|---|---|
| 25 | Materiale zgjedhore(studentet) | 84,000 | 76,356 |
| 26 | Blerje uniformash dhe materiale sportive | 360,000 | 266,400 |
| 27 | Rimbushje bombola gazi | 72,000 | - |
| 28 | Sherbim i ruajtjes me sistem alarmi | 120,000 | 117,600 |
| 29 | Energji | 2,120,000 | 2,172,913 |
| 30 | Uje | 797,462 | 733,922 |
| 31 | Telefon | 635,000 | 600,659 |
| 32 | Sherbim postar | 123,000 | 83,620 |
| 33 | Sherbime te ndryshme (detyrime tarifore ba | 5,556,212 | 381,315 |
| 34 | Kosto legale (mirembajtje kontrate etj) | 276,727 | - |
| 35 | Kosto te seancave te bordeve ,senati | 4,326,000 | 4,206,000 |
| 36 | Dieta (brenda ,jashte,ekspedita ) | 4,100,000 | 3,932,261 |
| 37 | Shpenzime per Qeverine Studentore | 3,000,000 | 850,463 |
| 38 | Trasferta te jashtme 605 | 966,551 | 400,930 |
| 39 | Shpenzime pritje e percjellje | 700,000 | 292,700 |
| 40 | Aktivitete shkencore, kumtesa,konferenca, | 3,400,000 | 2,161,244 |
| 41 | Sherbime te tjera | 1,725,670 | 915,752 |
| 42 | Materiale specifike | 200,000 | 45,000 |
| 43 | Sherbime specifike | 200,000 | 126,137 |
| 44 | Kosto reklam.dhe publikimi (spote, aktivite | 500000 | |
| 45 | ProjektiTe Comp UGJ | 2,000,000 | |
| 46 | Projekti Ineco | 1,400,000 | |
| | Shuma | **32,662,622** | **17,363,272** |
| | **Totali i shpenzimeve operative** | **46.835.988** | **29.670.762** |

**III- Financimi për Investime dhe Studime Projektime.**

**a) Në zërin e investimeve kemi një realizim prej 30 %** të të ardhurave të parashikuara. Kjo ka ardhur si rezultat i realizimit të prokurimeve në një vlerë më të ulët se ajo e planifikuar nga specialistët.Për vitin 2019 ka mosrealizim për shkak se kishim planifikuar një shumë të konsiderueshme ,por jo të mjaftueshme për rikonstruksionin e ish shtëpisë së Ushtarakëve.Nga ana e MASR –së është kërkuar që rikonstruksioni të realizohej nga ana e ministrisë me fonde nga Buxheti i Shtetit .Prandaj dhe për vitin 2020 nuk kemi planifikuar fonde për rikonsruksionin e ambjenteve në ish shtëpinë e ushtarakëve. Një pjesë e ambjenteve në ish shtëpinë e ushtarakëve kaloi në përdorim të ADIS-sës Në vitin 2019 është kryer prokurimi për rikonstruksionin e nyjeve hidrosanitare me vlerë prej 7.278.330 lekë dhe eshte shpallur fituesi me vlere 4.741.336 lekë.



REPUBLIKA E SHQIPERISE UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

**b)Në zërin Studime Projektime kemi realizim prej 5 %,** Këtu është bërë planifikimi për pagesën e projektit të objektit "Rishikimi i projektit të shtëpisë së Ushtarakëve", pasi një pjesë e saj u kalua në administrim të Adisë-s.Por duke qënë se zëri studime projektime është i lidhur me zërin investime rrjedhimisht edhe ky zë është realizuar në këtë masë kaq të ulët.

## STUDIME PROJEKTIME DHE INVESTIME

| Investime | Plan | Fakt |
|---|---|---|
| Paisje kompjuterike dhe elektronike | 2,100,000 | 1,669,200 |
| Paisje zyre mobileri | 960,000 | 756,000 |
| Mjete didaktike | 120,000 | - |
| Libra per biblioteken dhe per studentet | 2,400,000 | 1,985,179 |
| Rikonstruksion i nyjeve hidrosanitare | 7,278,330 | - |
| Supervis nyje hidrosanitare | 393,600 | - |
| Kolaudim nyje hidrosanitare | 121,200 | - |
| Laboratori i gjuheve te huaja | 2,400,000 | 2,100,000 |
| Rikonstruksion i ish-Shtepise se Ushtarakeve | 12,000,000 | - |
| Supervizim ish shtepia e ushtarakeve | 600,000 | - |
| Kulidim ish shtepia e ushtarakeve | 240,000 | |
| Leje ndertimi ish shtepia e ushtarakeve | 72,000 | - |
| Blerje kamera vezhgimi, sistem alarmi | 120,000 | 114,600 |
| Stenda per njoftime | 120,000 | 117,600 |
| Blerje aparate kondicioner | 240,000 | 216,000 |
| Rikonstruksion ambjente te brendshme | 960,000 | 706,800 |
| Sistem aspirimi per sallen e bibliotekes | 360,000 | - |
| Trupa kaloriferi te kaldajes | 720,000 | 696,000 |
| Projekti I mbrojtjes nga zjarri | 80,000 | 70,200 |
| Blerje pajisje e instrumenta Laboratorike" për Laboratorin e Arkeologjisë dhe Restaurimit | 3,552,890 | 3,552,840 |
| Blerje pajisje e instrumenta Laboratorike" për Projektin kërkimor për aplikimin e ICT në mësimdhënien e ICT. | 4,090,000 | 3,344,400 |
| **TOTALI** | **38,928,020** | **15,328,819** |

**PARASHIKIMI DHE REALIZIMI I FONDEVE NË TOTAL PER VITIN 2019 JEPEN NË TABELËN E MËPOSHTME:**

| Nr. | Emërtesa | Plani<br>Viti 2019 | Realizimi<br>Viti 2019 | % e Realizimit me planin fillestar |
|---|---|---|---|---|
| 1 | Fondi i pagave | 200.114.941 | 194.193.239 | 97% |
| 2 | Sigurime shoqerore | 30.500.000 | 29.219.177 | 96% |
| 3 | Shpenzime operative | 43.435.984 | 29.670.767 | 68% |
| 4 | Bursa e transferime | 14.071.215 | 9.497.120 | 68% |
| 5 | Investime e studime projektime | 42.328.020 | 15.328.819 | 36% |
| | Gjithsej | 330.450.159 | 277.909.122 | 84% |

Bashkëngjitur Evidenca e Realizimit të Shpenzimeve Janar- Dhjetor 2019, Evidenca e Realizimit të të Ardhurave, të konfirmuar nga Dega e Thesarit Gjirokastër.

**ADMINISTRATOR**

**Semi GOLEMI**

REPUBLIKA E SHQIPERISE -UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"- GJIROKASTËR

REPUBLIKA E SHQIPERISE -UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"- GJIROKASTËR

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"

GJIROKASTËR

ADMINISTRATORI

Nr. 197 prot.

Gjirokastër, më 11.02.2019

Lënda : Raporti Vjetor Financiar për vitin 2018.

**BORDIT TË ADMINISTRIMIT**

**KËTU**

Në zbatim të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë"*, të Ligjit Nr.80/2015 datë 22.07.2015, *"Për arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë"* neni 32, të ligjit nr.99/2018 datë 03.12.2018 "Për buxhetin e vitit 2019", të Udhëzimit nr.2, datë 06.02.2012 *"Për proçedurat standarte të zbatimit të buxhetit"*,të ndryshuar, gjendjes reale të zbatimit të buxhetit, konform miratimeve, nga Bordi i Administrimit të Universitetit "Eqrem Cabej" , konfirmuar dhe nga Dega e Thesarit Gjirokastër, është pregatitur për miratim Raporti Vjetor Financiar për vitin 2018 për veprimtarinë financiare të institucionit si më poshtë:

**Aktiviteti financiar për vitin 2018 është bazuar në dy burime financimi si më poshtë :**

1-**Financimin nga buxheti i Shtetit** në formën e trasfertës së pakushtëzuar në vlerën 274.992.000 lekë.

2-**Financimin nga të ardhurat e Institucionit** në vlerën prej 75.238.000 lekë.

REPUBLIKA E SHQIPERISE - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTER

Financimi nga buxheti i shtetit prej 274.992.000 lekë e ndarë sipas zërave të shpenzimeve jepet në tabelën e mëposhtme:

| Nr. | Emërtesa | Plani<br>Viti 2018 | Realizimi<br>Viti 2018 | % e Realizimit me planin fillestar |
|---|---|---|---|---|
| | | Trasferta pakushtezuar | Trasferta pakushtezuar | |
| 1 | Fondi i pagave | 189.933.910 | 189.933.910 | 100% |
| 2 | Sigurime shoqerore | 30.000.000 | 30.000.000 | 100% |
| 3 | Shpenzime operative | 46.692.000 | 37.024.300 | 79% |
| 4 | Bursa e transferime | 8.366.090 | 7.049.170 | 84% |
| 5 | Investime | 0 | 0 | 0 |
| | Gjithsej shpenzime | 274.992.000 | 264.007.380 | 96% |

Nga Trasferta e pakushtëzuar e akorduar për 2018 është përballuar:
1- pagesa e pagave të punonjësve akademikë dhe administrativ, sipas strukturës organike të miratuar. Ky fond është realizuar në masën 100%..
2- pagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore nga punëdhënësi në masën 100%. Trasferta e pakushtëzuar e akorduar për vitin 2018, ka qënë në limitin që na lejoi të përballonim pagesat e planifikuara për shpenzime në fillim të vitit, duke përballuar edhe zërin e shpenzimeve operative .Sic shihet edhe nga tabela, realizimi i trasfertës së pakushtëzuar në përqindje është i lartë dhe në vlerë absolute.Ka fonde të papërdorura tek:
1-Zëri shpenzimet operative në vlerën prej 9.201.147.06 lekë
2- Zëri transferime korrente jashtë shtetit në vlerën prej 466.551.29 lekë,
3- Zëri bursa për studentët në vlerën prej 1.316.925 lekë.Në total **10.984.623.35** lekë.Nga fondi i pagave gjatë vitit janë dhënë shpërblime për raste të vecanta në vlerën prej 866.050 lekë. -4-Zëri i shpenzimeve operative së bashku me transferimet korrente jashtë shtetit në fillim të vitit 2018 është planikuar një vlerë prej 40.492.000 lekë nga Buxheti i Shtetit,por në vazhdim për arsye të nevojave si edhe festimeve në kuadrin e 50-vjetorit te Universitetit,me vendim të Bordit të Administrimit u transferua fondi prej 6.200.000 lekë nga pagat tek shpenzimet operative,për lyerjen e Institucionit.

**<u>Për financimin nga të ardhurat dytësore për vitin 2018, jemi bazuar</u>**

**1.në krijimin e të ardhurave dytësore për Universitetin"Eqrem Çabej" Gjirokastër që janë sipas tabelës së mëposhtëme:**

| Nr | Lloji i të ardhurave | Viti 2018 |
|---|---|---|
| 1 | *Qera* | *33.000* |
| 2 | *Tarifa Shkollimi* | *36.123.121* |
| 3 | *Vërtetime e te tjera* | *3.166.684* |
| 4 | *Tarife regjistrimi e te tjera (kredite te pashlyera)* | *1.017.500* |
| 5 | *Te ardhura nga financime te huaja* | *530.000* |
| | ***SHUMA*** | ***40.870.305*** |

**2. në të ardhurat e trashëguara në vite .**

Financimi nga të ardhurat e Institucionit prej 75.238.000 lekë e ndarë sipas zërave të shpenzimeve jepet në tabelën e mëposhtme:

| Nr. | Emërtesa e shpenzimeve | Viti 2018 | | |
|---|---|---|---|---|
| | | **Limiti i përdorimit** | **Realizimi** | **% e Realizimit me planin fillestar** |
| 1 | Fondi i pagave | **20.000.000** | **17.328.861** | **87 %** |
| 2 | **Shpenzime Operative** | **4.823.132** | **1.334.611** | **27 %** |
| 3 | **Investime** | **46.940.268** | **7.064.968** | **15 %** |
| 4 | **Studime projektime** | **3.474.600** | **138.450** | **4%** |
| | **Shuma** | **75.238.000** | **25.866.890** | **34%** |

Sic shihet edhe nga tabela e mësipërme për vitin 2018, të ardhurat janë realizuar në vlerën 40.870.305 lekë gjithsej, nivel ky më i ulëti vitet e fundit.Duke analizuar të ardhurat e realizuara të Universitetit gjatë viteve të fundit ato janë ulur, në një masë të konsiderueshme, pavarësisht

REPUBLIKA E SHQIPERISE - UNIVERSITETI "EQREM CABEJ" GJIROKASTER

nga hapja e programeve të studimit "Master Profesional" dhe "Master Shkencor", sepse pothuajse në të gjitha programet e studimit të Universitetit, sepse:

-numri i studentëve të regjistruar ka ardhur në ulje përkatësisht :

për vitin akademik 2015-2016 1770 studentë

për vitin akademik 2016-2017 1626 studentë

për vitin akademik 2017-2018 1454 studentë

-një pjesë e tarifës së shkollimit të studentëve është arkëtuar që në muajt nëntor–dhjetor 2017, -

- trajtimi i një numri të madh studentësh , të cilët vijnë nga shtresa sociale në nevojë, me prindër invalid ose të përndjekur politik etj dhe nuk e paguajnë ose e paguajnë pjesërisht tarifën e shkollimit sipas sistemit të studimit përkatës.Për vitin akademik 2017- 2018 janë përjashtuar nga tarifa 120 studentë të bachelorit dhe 12 studentë të masterit në vlerën 2.940.000 lekë.

Në katër vitet e fundit realizimi i të ardhurave është si më poshtë:

Viti 2015: 66.753.400 lekë

Viti 2016 62.799.799 lekë

Viti 2017 49.688.000 lekë

Viti 2018 40.870.305 lekë

Në vitin 2018 realizimi i të ardhurave është në masën 40.870.305 lekë

Nga viti 2017 janë trashëguar 90.635.218.04 lekë të ardhura

Gjatë vitit 2018 janë përdorur 25.866.893 lekë nga të ardhurat

Për vitin 2019 trashëgohen 105.638.630.04 lekë të ardhura .

Plani i limitit të përdorimit nga të ardhurat dytësore për vitin 2018 në total është 75.238.000 lekë, nga i cili është realizuar në vlerën 25.866.890 lekë, përfshirë ndryshimet e herëpashershme (të cilat janë miratuar rast pas rasti nga Bordi i Administrimit) ku të detajuar sipas artikujve të shpenzimeve i analizojmë më poshtë:

**I- Financimi nga të ardhurat dytësore në zërin e pagave** ka përfshirë pagesën e orëve të pedagogëve të ftuar (5.183.350 lekë), orët jashtë kohës normale të punës, orët suplementare (15.126.023 lekë). Me fondin e mësipërm të pagave janë mbuluar të gjitha shpenzimet sipas shkresave të ardhura nga Dekanatet dhe Departamentet për të gjithë punonjësit efektiv dhe ata të jashtëm për vitin 2018.Ka një mosrealizim tek ky zë, pasi në fondin e planifikuar në fillim të vitit është planifikuar të likuidohen edhe orët e realizuara mbi 30% të ngarkesës mësimore, por me



REPUBLIKA E SHQIPERISE - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" - GJIROKASTER

miratimin e tyre në senat dhe në Bordin e Administrimit këto orë janë paguar një pjesë nga buxheti i shtetit dhe një pjesë nga të ardhurat e Institucionit, bazuar në shkresën e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit për sasinë e tyre .

**II-Financimi nga të ardhurat dytësore për shpenzimet operative:**

Fondi për shpenzimet operative është planifikuar nga të ardhurat e institucionit në masën 5.878.000 lekë lekë në total, ku gjatë vitit janë bërë rialokime të ndryshme, brenda limitit të përdorimit të të ardhurave të miratuara në fillim të vitit, të cilat janë miratuar në BA-në e Universitetit dhe të detajuara jepen në Regjistrin e Realizimit të Prokurimeve Publike. Brenda limitit të celur në fillim të vitit, duke pare realizimin e pritshëm të shpenzimeve janë bërë rialokimet përkatëse . Të gjitha këto rialokime janë dërguar për miratim në BA-it dhe janë miratuar me vendimet përkatëse, duke i pasqyruar në Regjistrin e Parashikimeve Publike, të ndryshuar, ku janë njoftuar edhe Zyra e Prokurimeve pranë MAS-it edhe Dega e Thesarit Gjirokastër.Shpenzimet sipas zërave të detajuara janë dhënë tek tabela e Regjistrit të Realizimit të Prokurimeve. Në tabelë është dhënë planifikimi dhe realizimi sipas zërave me gjithë ndryshimet përkatëse të miratuara gjatë vitit nga Bordi i Administrimit.

Nga zëri i shpenzimeve operative u financuan shpenzimet për kontratat e prokuruara dhe për shpenzimet me blerje të vogël, ku për arsye se janë planifikuar nga të ardhurat e institucionit, i është dhënë rëndësi të vecantë efektivitetit të tyre, me qëllim realizimin e shpenzimeve më të domosdoshme për të mbajtur një rezervë që është e trashëgueshme për vitin në vazhdim.

Realizimi i shpenzimeve operative është në vlerën afërsisht 34 % të të ardhurave.Në vitin 2018

krahas zëravëe të tjerë të shpenzimeve është realizuar mirëmbajtja e hollit dhe zyrave të katit të parë,si edhe mirëmbajtja e murit rrethues.

Shpenzimet sipas zërave janë të detajuar si nga buxheti ashtu edhe nga të ardhurat në tabelën e realizimit të shpenzimeve si më poshtë:

REPUBLIKA E SHQIPERISE - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" - GJIROKASTËR

| | Objekti i prokurimit | Fondi limit PLAN | Fondi limit FAKT |
|---|---|---|---|
| 1 | Roje civile(kontrate shtese) | 870,972 | 870,972 |
| 2 | Roje civile | 4,180,672 | 4,180,671 |
| 3 | Karburant | 1,700,000 | 1,699,819 |
| 4 | Sherbime te printimit dhe publikimit | 782,000 | 681,841 |
| 5 | Kancaleri, boje fotokopje,printeri | 1,700,000 | - |
| 6 | Materiale pastrimi | 240,000 | 200,400 |
| 7 | Mirembajtje kompjuterike | 350,000 | 334,800 |
| 8 | Mirembajtje dhe riparim fotokopjues, printer | 250,000 | 170,000 |
| 9 | Materiale elektrike,hidraulike dhe ndertimi | 350,000 | 275,988 |
| 10 | Furnizime per zyra | 490,400 | 402,500 |
| 11 | Blerje ilace dhe materiale te tjera per laboratore | 120,000 | 100,000 |
| 12 | Mirembajtje mjet transporti (dy mjete) | 600,000 | 478,800 |
| 13 | Kuota e sigurimit te mjeteve autoveture M-Benz | 86,260 | 86,260 |
| 14 | Kuota e sigurimit te mjeteve furgon M-benz | 120,000 | 93,816 |
| 15 | Abonim per sherbim interneti | 157,800 | 107,876 |
| 16 | Mirembajtje te aparateve kondicionere | 300,000 | 264,000 |
| 17 | Mirembajtje te kaldajeve | 120,000 | 98,500 |
| 18 | Mirembajtje e gjeneratorit | 120,000 | 116,200 |
| 19 | Sherbime te ndryshme te paspecifikuara dhe em | - | - |
| | Lyerja e brezave | 87,334 | 85,334 |
| | Tabela orientuese | 198,000 | 196,500 |
| | Blerje pleh organik | 48,000 | 48,000 |
| | Sherbim me qender zeri | 24,000 | 13,000 |
| | Dezinfektimi I ambjenteve | 48,000 | 48,000 |
| 20 | Bileta avioni | 700,000 | 643552 |
| 21 | Mirembajtje taracave | 111,967 | 99,967 |
| | Shuma | **13,755,405** | **11,296,796** |

| | | | |
|---|---|---|---|
| 22 | Mirembajtje e zyrave te katit te pare, l | 640,000 | 540,000 |
| 23 | Mirembajtja e murit rrethues dhe kana | 1,945,354 | 1,886,665 |
| 24 | Mirembajtje dhe riparime e banjave | 120,000 | 101,458 |
| 25 | Sistemim i ambjentit te jashtem (lulish | 120,000 | 120,000 |
| 26 | Mirembajtje sistemi i informatik dhe s | 598,800 | 579,000 |
| 27 | Mirembajtje sistemi elektrik | 280,000 | 228,000 |
| 28 | Ndricimi i ambjenteve te jashtme dhe | 680,000 | 654,000 |
| 29 | Mirembajtje sistemi i fonise (auditor, | 250,000 | 234,932 |
| 30 | Energji | 2,232,666 | 2,018,615 |
| 31 | Uje | 680,000 | 671,353 |
| 32 | Telefon | 725,000 | 703,587 |
| 33 | Sherbim postar | 180,000 | 122,322 |
| 34 | Sherbime te ndryshme (detyrime tarif | 500,000 | 399,784 |
| 35 | Kosto legale (mirembajtje kontrate e | 150,000 | 108,000 |
| 36 | Kosto te seancave te bordeve ,senat | 2,616,000 | 2,616,000 |
| 37 | Dieta (brenda ,jashte,ekspedita ) | 4,200,000 | 3,941,854 |
| 38 | Shpenzime per Qeverine Studentore | 1,585,132 | 1,263,590 |
| 39 | Trasferta te jashtme 605 | 500,000 | 33,450 |
| 40 | Shpenzime pritje e percjellje(50 vjetor | 600,000 | 550,000 |
| 41 | Aktivitete shkencore, kumtesa,konfer | 5900000 | 3,720,913 |
| 42 | Sherbime te tjera (pagesa te senatit dh | 3,136,000 | 2,839,149 |
| 43 | Materiale specifike | 300000 | 39,416 |
| 44 | Sherbime specifike | 200000 | 200,000 |
| 45 | Kosto reklam.dhe publikimi (spote, fl | 1,500,000 | 989,326 |
| 46 | Lyerje e ambjenteve | 5,365,000 | |
| 47 | Mirembajteje ambjenti tek shatervani e | 480,575 | 372,000 |
| 49 | Materiale dhe sherbime per 50 vjetorin | 960,000 | 936,000 |
| 50 | Riparimi I paisjeve tek klasat | 960,000 | 909,600 |
| 51 | Blerje medalje (3 ari dhe 11argjendi) | 132,000 | 103,504 |
| 52 | Blerje uniforma per punonjes informa | 24,000 | 15,600 |
| 53 | Blerje materiale per ambjente jashte | 199,200 | 164,000 |
| | **Shuma** | 37,759,727 | 27,062,118 |
| | **Totali i shpenzimeve operative** | **51,515,132** | **38,358,914** |

REPUBLIKA E SHQIPERISE - UNIVERSITETI "EQREM CABEJ" - GJIROKASTER

**III- Financimi për Investime dhe Studime Projektime.**

a) **Në zërin e investimeve kemi një realizim prej 15 %** të të ardhurave të parashikuara. Kjo ka ardhur si rezultat i realizimit të prokurimeve në një vlerë më të ulët se ajo e planifikuar nga specialistët tanë.Për vitin 2018 ka mosrealizim për shkak se kishim planifikuar një shumë të konsiderueshme .por jo të mjaftueshme për rikonstruksionin e ish shtëpisë së Ushtarakëve e cila nuk u krye për shkak se rishikimi i projektit nuk mund të kryhej në kohë ,projekti për ish shtëpinë e ushtarakëve i hartuar nuk mund të vihej në zbatim sepse :

1-për arsye se në zbatim të ligjit nuk krye investimi brenda 3 viteve.

2-një pjesë e ambjenteve neë ish shtëpinë e ushtarakëve kaloi në përdorim te ADIS- Për këtë objekt i cili ishte miratuar gjatë vitit 2018 në BA-në e Universitetit dhe nuk i kemi realizuar, kemi menduar ti realizojmë në vazhdim,pasi kemi realizuar rishikimine projektit falas .

Në vitin 2018 është kryer investimi për akomodimin e sekretareve në një ambjent të përbashkët me qëllim mbarëvajtjen e punës si dhe për tu shërbyer studentëve në kohë reale

b)**Në zërin Studime Projektime kemi realizim prej 4 %,** ku është bërë planifikimi për pagesën prej 40% e projektit të objektit "Rishikimi i projektit të shtëpisë së Ushtarakëve", pasi një pjesë e saj u kalua në administrim të Adisë-s dhe sipas legjislacionit në fuqi mund të bëhet rishikim projekti në masën 40% të projektit fillestar.Por duke qënë se zëri studime projektime është i lidhur me zërin invesitme rrjedhimisht edhe ky zë është realizuar në këtë masë kaq të ulët.

REPUBLIKA E SHQIPERISE • UNIVERSITETI "EQREM CABEJ" GJIROKASTER

## STUDIME PROJEKTIME DHE INVESTIME

| Investime | Plan | Fakt |
|---|---|---|
| Paisje kompjuterike dhe elektronike | 960,000 | 838,800 |
| Paisje zyre mobileri( katedra .derrasa, tavolina e | 960,000 | 765,600 |
| Mjete didaktike harta lab etj | 120,000 | 118,440 |
| Libra per biblioteken dhe per studentet | 2,500,000 | 2,490,550 |
| Kualidim, rikonstruksion ish-Sh.U. | 532,619 | 0 |
| Supervizim sh u | 1,183,463 | 0 |
| Rishikim i projektit te Shtepise se Ushtarakeve | 2,400,000 | 0 |
| Projekt i murit rrethues,supervizor,kualidator | 96,000 | 83,608 |
| Projekt i sistemimit te sekretarive,supervizor,kua | 96,000 | 69.450 |
| Rikonstruksion i ish-Shtepise se Ushtarakeve | 38,097,785 | 0 |
| Blerje kamera vezhgimi | 300,000 | 226,800 |
| Bazament mbajtes per videoprojektore | 120,000 | 116,400 |
| Pershtatje ambjenti per sekretaret | 2,000,000 | 1,789,388 |
| Blerje aparate kondicioner | 680575 | 573,600 |
| Leje ndertimi. | 114133 | 0 |
| Zhvendosje e deres te klasa e anglishtesdhe mire | 60000 | 59.982 |
| Instalimi I sistemit te alarmit te sekretarite | 60000 | 58,800 |
| Leje per lyerje | 1000 | 0 |
| Preventiv per lyerje | 12600 | 12,000 |
| Supervizor per lyerje | 107762 | 0 |
| Kolaudator per lyerje | 12931 | 0 |
| **Shuma** | ***50,414,868*** | ***7,203,418*** |

**Parashikimi dhe realizimi per vitin 2018 jepen sipas tabelës së mëposhtme:**

| Nr. | Emërtesa | Plani<br>Viti 2018 | Realizimi<br>Viti 2018 | % e Realizimit me planin fillestar |
|---|---|---|---|---|
| 1 | **Fondi i pagave** | **209.624.440** | **206.953.298** | **98.7%** |
| 2 | **Sigurime shoqerore** | **30.309.470** | **30.309.470** | **100%** |
| 3 | **Shpenzime operative** | **51.515.132** | **38.358.917** | **74%** |
| 4 | **Bursa e transferime** | **8.366.090** | **7.049.170** | **84%** |
| 5 | **Investime** | **50.414.868** | **7.203.418** | **14%** |
|  | **Gjithsej** | **350.230.000** | **289.874.270** | **82.7%** |

REPUBLIKA E SHQIPERISE - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" - GJIROKASTËR

Bashkëngjitur Evidenca e Realizimit të Shpenzimeve Janar- Dhjetor 2018, Evidenca e Realizimit të të Ardhurave, të konfirmuar nga Dega e Thesarit Gjirokastër.

**ADMINISTRATOR**

**Gentian LLOGO**

REPUBLIKA E SHQIPERISE - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

Konceptoi

Marianthi XHA

REPUBLIKA E SHQIPERISE - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" GJIROKASTËR

Universiteti "Eqerem Cabej"
1011108

Situacioni i shpenzimeve per periudhen Janar - dhjetor 2018

| Art | | ANALIZA | ondet e buxhetit | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | N/Art | Emertimi | Tit 9450,K 8 | Tit09450k6 | Shuma mujore | Tit 9450 K8 | tit09450k6 | Totali |
| 230 | | PLAN | | | | | | |
| | | Fakt | | | | | | |
| | 2302100 | Shpenzime per studime e kerkime | | 12000 | 12,000 | | 3,474,600 | 3,474,600 |
| 231 | | PLAN | | 12000 | 12,000 | | 138,450.00 | 138,450 |
| | | Fakt | | | | | 138,450.00 | 138,450.00 |
| | 2312101 | Shp.ndertesa administrative | | 1604400 | 1604400 | | 46,940,268 | 46,940,268 |
| | 2312103 | Shp.ndertesa shkollore | | | | | 7,064,968.00 | 7064968 |
| | 2312112 | Shp. Per krijim fondi biblioteke | | | | | 1,849,370.00 | 1,849,370.00 |
| | 2313500 | Shp. Perinstalimin e rrjetit kompjuterik | | | | | 26,608.00 | 26,608.00 |
| | 2313600 | Shp.per konstruksionin e rrugeve | | | | | 2.490,550.00 | 2,490,550.00 |
| | 2314110 | Shp.paisje dhe shpenzime instaluaese | | | | | | |
| | 2314130 | Shpenz.Paisje qe sigurojne energji | | | | | | |
| | 2314140 | Shpenz.Paisje dhe insrtrumenta laboratorike | | | | | | |
| | 2314160 | Shpenz .Instalimi I sisitemit te komjuterave | | | | | | |
| | 2314170 | Shpenz .Paisje dhe instalim I kondicionereve | | | | | | |
| | 2314320 | Shpenz mjete dhe paisje te tjerateknike | | | | | | |
| | 2315120 | Shpenz. Makina | | | | | 632,400.00 | 632,400.00 |
| | 2315130 | Shpenz .Autobuze | | | | | | |
| | 2315210 | Shpenz Mjete te tjera | | | | | | |
| | 2318100 | Shpenz. Orendi zyre | | | | | | |
| | 2318400 | Shpenz.Fotokopje | | | | | | |
| | 2318500 | Shpenz. Fakse | | | | | | |
| | 2318600 | Shpenz. Paisje komjuteri | | | | | | |
| A000301 | 2318700 | Shpenz. Te tjera paisje zyre | | 838,800 | 833,800 | | | |
| | 2318700 | Ngurtesim garancie per paisje zyre | | 765,600 | 765,600 | | 838,800.00 | 838,800.00 |
| 466 | | PLAN | | | | | 1,227,240.00 | 1,227,240.00 |
| | | Fakt | | | | | | |
| | 4662103 | Garanci te vitit vazhdim per sigurim kontrat | | | | | | |
| 600 | | | | | | | | |
| | | PLAN | | | | | | |
| | | Fakt | | | | 189,933,910 | 20,000,000 | 209,933,910 |
| | 6001001 | Paga baze | 19,244,835 | 4,127,894 | 23,372,729 | 189,933,907.00 | 17,019,391.00 | 206,953,298 |
| | 6001002 | Raport mjekesor pun. dh. | 11,971,457 | 1221610 | 13,193,067 | 161,757,484.00 | 12,414,065.00 | 174,171,549 |
| | 6001003 | shtese e vjetersi | 6017 | | 6,017 | 31,580.00 | | 31,580 |
| | 6001004 | shtese page veshtiresi | 930,027 | | 93[illegible],027 | 10,686,477.00 | 1,020,384.00 | 11,706,861 |
| | 6001005 | shtese page funksion | | | | | | |
| | 6001006 | shtese pune me turne II -III | 26,784 | | 26,784 | 312,651.00 | 36,865.00 | 349,516 |
| | 6001007 | shtese iargesi vend banimi | | | | | | |
| | 6001013 | Shtes per pune jasht.ora. | | | | | | |
| | 6001099 | shtesa page te tjera | | 40884 | 40,884 | 158,869.00 | 234,576.00 | 393,445 |
| | 6002002 | Page per pun.me kontrat | 14,714 | | 14,714 | 292,061.00 | 1,101.00 | 293,162 |
| | 6003100 | shperblime per rez.pune | | | | 51,879.00 | | 51,879 |
| | 6003200 | shperblima takse solidariteti | | | | | | |
| | 6003300 | paga e 13 - te | | | | | | |
| | 6003900 | Te tjera shperblime personeli. | | | | | | |
| | 6009100 | Shpenzime te tjera personeli | | | | | | |
| | 6001008 | Pagegrupi | | | | | | |
| | 6001014 | shtesa qe pag.akte te vecanta | 442,494 | | 442,494 | 4,787,068.00 | 447,000.00 | 5,234,068 |
| 601 | | PLAN | 5,853,342 | 2,865,400 | 8,718,742 | 11,855,838.00 | 2,865,400.00 | 14,721,238 |
| | | Fakt | 2,249,310 | 309,470 | 2,558,780 | 30,000,000 | | 30,000,000 |
| | 6010100 | Kontributeper sig shoqerore | 2,183,079 | | 2,183,079 | 30,000,000.00 | 309,470.00 | 30,309,470 |
| | 6011100 | Kontributeper sig shendetsor | 66,231 | 309470 | 375,701 | 26,814,870.00 | | 26,814,870 |
| 602 | | PLAN | | | | 3,185,130.00 | 309,470.00 | 3,494,600 |
| | | Fakt | 12,252,988 | 615,948 | [illegible],868,938 | 46,192,000 | 4,823,132 | 51,015,132 |
| 6020 | 6020100 | Kanceleri | 776,266 | 69,841 | 846,107 | 36,990,853.00 | 1,334,611.00 | 38,325,464 |
| | 6020200 | Mater.Past.ngrohje e ndriçim | 270,000 | 5,988 | 275,988 | 2,029,464.00 | 69,841.00 | 2,099,305 |
| | 6020300 | Materper funks e paisjeve te zyres | | | | 420,000.00 | 56,388.00 | 476,388 |
| | 6020400 | Matter per funk.e paisj.spec. | | | | 402,500.00 | | 402,500 |
| | 6020500 | Blerie dokumentacioni | | | | | | |
| | 6020900 | F.mat.Zyra dhe te pergjitheshme | | | | | | |
| | 6020901 | F.mat.Zyra dhe te pergjitheshme | | | | | | |
| | | shuma | 1,046,266 | 76,829 | [illegible],122,095 | 2,851,864.00 | 126,2[illegible].08 | 2,[illegible]193 |
| 6021 | 6021001 | unifora e veshje te tjera speci | 15,600 | | 15,600 | 15,600.00 | | 15,600 |
| | 6021003 | laçe dhe mat mjeksore | | | | | | |
| | 6021007 | Libra dhe publikime speciale | | | | | | |

REPUBLIKA E SHQIPERISE - UNIVERSITETI "EQREM CABEJ" GJIROKASTER

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | 6021009 | Material dhe paisje laboratori(elektrik,hidra) | | | | 84,000.00 | 16,000.00 | 100,000 |
| | 6021099 | Te tj. mat. Dhe sherbim spec | 2,898,712 | | 2,898,712 | 5,557,962.00 | | 5,557,962 |
| | | shuma | 2,914,312 | | 2,914,312 | 5,657,562.00 | 16,000.00 | 5,673,562 |
| 6022 | 6022001 | Elektricitet | 7,278 | | 7,278 | 2,018,615.00 | | 2,018,615 |
| | 6022002 | Uje | 110,245 | | 110,245 | 671,353.00 | | 671,353 |
| | 6022003 | Sherbime telefonike | 66,928 | | 66,928 | 811,463.00 | | 811,463 |
| | 6022004 | Posta e sherb.korrier | 22,560 | | 22,560 | 122,322.00 | | 122,322 |
| | 6022007 | sherbime bankare | | | | 13,583.00 | | 13,583 |
| | 6022008 | sherbime te sig e te ruajtjes | 1,169,821 | | 1,169,821 | 5,051,643.00 | | 5,051,643 |
| | 6022009 | sherb.te pastr.dhe gjelberimit | | | | | | |
| | 6022010 | Sherbime te printimit dhe pub | 76,094 | | 76,094 | 76,094.00 | | 76,094 |
| | 6022011 | kosto e trajnimit dhe e semin. | | | | | | |
| | 6022099 | sherbime te tjera. | 739,570 | | 739,570 | 1,152,350.00 | | 1,152,350 |
| | | shuma | 2,192,496 | | 2,192,496 | 9,917,423.00 | | 9,917,423 |
| 6023 | 6023100 | karburant e vaj | 644,400 | 199,819 | 844,219 | 1,500,000.00 | 199,819.00 | 1,699,819 |
| | 6023200 | pjese kembimi goma e bateri | | | | | | |
| | 6023300 | shpenz.te sigurac mjeteve tr | | | | 182,806.00 | | 182,806 |
| | 6023900 | shpenzime te tjera trasporti | | | | 1,000.00 | | 1,000 |
| | | shuma | 644,400 | 199,819 | 844,219 | 1,683,806.00 | 199,819.00 | 1,883,625 |
| 6024 | 6024100 | U.brend.dieta brenda vendit | 383,260 | | 383,260 | 2,765,836.00 | 176,752.00 | 2,942,588 |
| | 6024200 | Udhetim e dieta jasht shtetit | 49,665 | | 49,665 | 1,890,858.00 | | 1,890,858 |
| | | shuma | 432,925 | | 432,925 | 4,656,694.00 | 176,752.00 | 4,833,446 |
| 6025 | 6025300 | shp.per mirem e obj.ndert | 405,139 | | 405,139 | 3,846,759.00 | 312,665.00 | 4,159,424 |
| | 6025400 | shp.per mirem.e rrugeve. | | | | | | |
| | 6025500 | shp. per mirem e apara. pais. | 1,803,500 | 229,000 | 2,032,500 | 2,028,400.00 | 229,000.00 | 2,257,400 |
| | 6025600 | shp.per miremb e mjet. trasp. | 11,920 | 18,800 | 30,720 | 460,000.00 | 18,800.00 | 478,800 |
| | 6025800 | shp.per miremb e paisjeve te | 30,500 | 42,500 | 73,000 | 344,000.00 | 105,632.00 | 449,632 |
| | | shuma | 2,251,059 | 290,300 | 2,541,359 | 6,679,159.00 | 666,097.00 | 7,345,256 |
| | 6028100 | Shpenzime per kuota qe rrjedh | 1,710,000 | | 1,710,000 | 3,680,900.00 | 99,714.00 | 3,780,614 |
| | | shuma | 1,710,000 | | 1,710,000 | 3,680,900.00 | 99,714.00 | 3,780,614 |
| 6029 | 6029001 | shp. per pritje e pere | 1061530 | 50,000 | 1,111,530 | 1,631,780.00 | 50,000.00 | 1,681,780 |
| | 6029002 | shp. per aktiv soc. Personeli | | | | | | |
| | 6029006 | Shpenzime per sigurimin e ndertesave | | | | | | |
| | 6029004 | Shpenzimekompesimi per anetaret e parlamentit | | | | | | |
| | 6029007 | Shpenzime per pjesmarrje ne konferenca | | | | 231,565.00 | | 231,565 |
| | 6029099 | shp. per te tjera materiale dhe sherbime | | | | | | |
| | | shuma | 1,061,530 | 50,000 | 1,111,530 | 1,863,345.00 | 50,000.00 | 1,913,345 |
| 606 | | Plan | | | | | | |
| | | Fakt | | | | 866,095.00 | | 866,095 |
| | 6040009 | Te tjera transferime | | | | 866,095.00 | | 866,095 |
| 605 | | PLAN | 500,000 | | | 500,000 | | 500,000 |
| | | Fakt | | | | 33,450.00 | | 33,450 |
| | 6059100 | Te tjera transferime korrente jashte shtetit | | | | 33,450.00 | | 33,450 |
| | | | | | | | | |
| 606 | | Plan | | | | 8,366,090 | | 8,366,090 |
| | | Fakt | 802,620 | | 802,620 | 6,183,076.00 | | 6,183,075 |
| | 6061021 | Bursa Kap 8 | 802,620 | | 802,620 | 6,183,075.00 | | 6,183,075 |
| 606 | | Plan | | | | | | |
| | | Fakt | | | | | | |
| | | Bonuse per shpenz, trans, | | | | | | |
| | | Plan | | | | | | |
| 9770 | | Fakt | | | | | | |
| | | Kerkime shkencore | | | | | | |
| TOTALI | | Plan | | | | 274,992,000 | 75,238,000 | 350,230,000 |
| | | Fakt | 34,549,753 | 6,669,712 | 41,219,465 | 264,007,380.00 | 25,866,890.00 | 289,874,270 |

| | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 466 | | PLAN | | | | | | |
| | | Fakt | | | | | | |
| | 4662103 | Garanci te vitit vazhdim per sigurim kontrat | | | | | 116,496 | 116,496 |
| | | | | | | | | |

*Dr. Sherbime Universitare*
*Marianthi Xha*

Specialiste e deges se Thesarit
Lumturi QIRJAQI

*Administrator*
Gentian Aqo

MINISTRIA E FINANCAVE DEGA E THESARIT GJIROKASTER

REPUBLIKA E SHQIPERISE - UNIVERSITETI "EQREM CABEJ" - GJIROKASTER

Qeveria Shqiperise, Accrual
DEGA E THESARIT TE RRETHIT - RAPORTIMI MUJOR (B/A/C)
Current Period: 12-2018



Currency: ALL
Institution=1011 08 (Universitet "E. Cabej", Gjirokaster (1111)), Treasury office=1111 (Gjirokaster - Gjirokaster)

| Line | Program | Ch | Inst. | Account | Buxheti | Accrual | Cash |
|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Shpenzimet (230-232, 600-609, 460) | | | | | | | |
| 11 | 09450 | 01 | 1011108 Universitet "E. Cabej", Gjiroka | 230 | 0,00 | 0,[illegible] | 0,00 |
| 11 | 09450 | 0[illegible] | 1011108 Universitet "E. Çabej", Gjiroka | 600 | 0,00 | 0,[illegible] | 0,00 |
| 11 | 09450 | 0[illegible] | 1011108 Universitet "E. Çabej", Gjiroka | 601 | 0,00 | 0,[illegible] | 0,00 |
| 11 | 09450 | 01 | 1011108 Universitet "E. Cabej", Gjiroka | 60[illegible] | 0,00 | 0,[illegible] | 0,00 |
| 11 | 09450 | 01 | 1011108 Universitet "E. Çabej", Gjiroka | 60[illegible] | 0,00 | 0,[illegible] | 0,00 |
| 11 | 09450 | 01 | 1011108 Universitet "E. Çabej", Gjiroka | 605 | 0,00 | 0,[illegible] | 0,00 |
| 11 | 09450 | 04 | 1011108 Universitet "E. Çabej", Gjiroka | 606 | 0,00 | 0,[illegible] | 0,00 |
| 11 | 09450 | 05 | 1011108 Universitet "E. Çabej", Gjiroka | 231 | 0,00 | 0,[illegible] | 0,00 |
| 11 | 09450 | 05 | 1011108 Universitet "E. Çabej", Gjiroka | 230 | 0,00 | 0,[illegible] | 0,00 |
| 11 | 09450 | 05 | 1011108 Universitet "E. Çabej", Gjiroka | 231 | 0,00 | 0,[illegible] | 0,00 |
| 11 | 09450 | 0[illegible] | 1011108 Universitet "E. Cabej", Gjiroka | 600 | 0,00 | 0,[illegible] | 0,00 |
| 11 | 09450 | 0[illegible] | 1011108 Universitet "E. Çabej", Gjiroka | 602 | 0,00 | 0,[illegible] | 0,50 |
| 11 | 09450 | 0[illegible] | 1011108 Universitet "E. Cabej", Gjiroka | 230 | 0,00 | 138,[illegible] | 139,45 |
| 11 | 09450 | [illegible] | 1011108 Universitet "E. Cabej", Gjiroka | 231 | 0,00 | 7.064,[illegible] | 7.06[illegible] |
| 11 | 09450 | [illegible] | 1011108 Universitet "E. Cabej", Gjiroka | 600 | 0,00 | 17.[illegible]19,59 | 17.07[illegible] |
| 11 | 09450 | [illegible] | 1011108 Universitet "E. Cabej", Gjiroka | 601 | 0,00 | 309,[illegible] | 30[illegible] |
| 11 | 09450 | [illegible] | 1011108 Universitet "E. Cabej", Gjiroka | 602 | 0,00 | 1.334,61 | 1.334,61 |
| 11 | 09450 | [illegible] | 1011108 Universitet "E. Cabej", Gjiroka | 605 | 0,00 | 0,00 | 0,00 |
| 11 | 09450 | [illegible] | 1011108 Universitet "E. Çabej", Gjiroka | 606 | 0,00 | 0,10 | 0,0[illegible] |
| 11 | 09450 | 05 | 1011108 Universitet "E. Cabej", Gjiroka | 600 | 169.933,91 | 139.933,[illegible] | 189.933,9[illegible] |
| 11 | 09450 | 08 | 1011108 Universitet "E. Cabej", Gjiroka | 601 | 30.000,00 | 30.000,[illegible] | 30.000,00 |
| 11 | 09450 | 08 | 1011108 Universitet "E. Çabej", Gjiroka | 602 | 46.292,00 | 46.096,[illegible] | 30.784,[illegible] |
| 11 | 09450 | 0[illegible] | 1011108 Universitet "E. Cabej", Gjiroka | 605 | 500,00 | 33,45 | 33,45 |
| 11 | 09770 | 01 | 1011108 Universitet "E. Cabej", Gjiroka | 606 | 8.366,10 | 9.049,17 | 9.241,55 |
| 11 | 09770 | 01 | 1011108 Universitet "E. Cabej", Gjiroka | 230 | 0,00 | 0,[illegible] | 0,00 |
| | | | 1011108 Universitet "E. Cabej", Gjiroka | 231 | 0,00 | 0,[illegible] | 0,00 |
| TOTAL DISTRICT | | | | | 274.093,00 | 289.874,[illegible] | 286.865,[illegible] |

REPUBLIKA E SHQIPERISE - UNIVERSITETI "EQREM CABEJ" - GJIROKASTER
MINISTRIA E FINANCAVE DHE EKONOMISE - DEGA E THESARIT - GJIROKASTER

DEGA E THESARIT
GJIROKASTER

INSTITUCIONI BUXHETOR
UNIVERSITETI "EQREM CABEJ"

# AKT RAKORDIM

PER VITIN 2018

| NR | KRIJUAR DHE PERDORUR PER VITIN 2018 | GJITHSEJ | TAKON INSTITUCIONIT | TAKON BUXHETIT | |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Sipas celjes se dt 01.01.2018 | | 90,635,218.04 | | |
| 2 | Krijuar gjate vitit 2018 | | 40,870,305 | | |
| 3 | GRANTI I VITIT 2018 | | | | |
| 4 | PakesuarGranti konkurues | | | | |
| 5 | Te ardhura nga institucionet ne mvaresi | | | | |
| | **SHUMA E TE ARDHURAVE (1+2+3+4)** | | 131,505,523.04 | | |
| 6 | Perdorur gjate vitit 2018 nga institucioni | | 25,866,893 | | |
| 7 | Perdorur gjate vitit 2018 nga institucionet ne mvaresi | | - | | |
| | **SHUMA E PERDORUR (5+6)** | | 25,866,893 | | |
| | Gjendje me 31.12.2018 per perdorim ne 2019 | | 105,638,630.04 | | |

D.SH.UNIVERSITARE
Marianthi XHA

ADMINISTRATOR
Gentian LLOGO

Per Degen e Thesarit
Specialiste e Shpenzimeve
Lumturi Qirjaqi

1011108 UNIVERSITETI "EQREM CABEJ" TE ARDHURAT E VITIT 2018

| Pershkrimi | Artikulli | Vlera gjithsej | | Buxheti | | Institucioni | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| Tarife rregj. | 7110103 | 1,017,500 | Lek | 0% | - | 100% | 1,017,500 | Lek |
| Tarife shko. | 7110109 | 36,123,121 | Lek | 0% | - | 100% | 36,123,121 | Lek |
| Te tj.te ardh. sek | 7111099 | 2,259,384 | Lek | 0% | - | 100% | 2,259,384 | Lek |
| Vertetime(te ard | 7110105 | 832,300 | Lek | 0% | - | 100% | 832,300 | Lek |
| Sponsorizime | 7207011 | 530,000 | Lek | 0% | - | 100% | 530,000 | Lek |
| Te Ardhura te tje | 7190990 | 75,000 | Lek | 0% | | 100% | 75,000 | |
| Qera | 7109600 | 33,000 | Lek | 0% | - | 100% | 33,000 | Lek |
| | TOTALI | 40,870,305 | Lek | | - | | 40,870,305 | Lek |

*Pergj. zyres finances*
*Parashqevi Kalanderi*

*Drejtore e Dr.Sherb.Univers.*
*Marianthi Xha*

*ADMINISTRATOR*
*Gentian LLOGO*

REPUBLIKA E SHQIPERISE - UNIVERSITETI "EQREM CABEJ" GJIROKASTER

DEGA E THESARIT
GJIROKASTER

INSTITUCIONI BUXHETOR
UNIVERSITETI "EQREM CABEJ"

# AKT RAKORDIM

PER VITIN 2018

| NR | KRIJUAR DHE PERDORUR PER VITIN 2018 | GJITHSEJ | TAKON INSTITUCIONIT | TAKON BUXHETIT | |
|---|---|---|---|---|---|
| 1 | Sipas celjes se dt 01.01.2018 | | | | |
| 2 | Krijuar gjate vitit 2018 | | | | |
| 3 | GRANTI I VITIT 2018 | | 274,992,000 | | |
| 4 | PakesuarGranti konkurues | | | | |
| 5 | Te ardhura nga institucionet ne mvaresi | | | | |
| | **SHUMA E TE ARDHURAVE (1+2+3+4)** | | 274,992,000 | | |
| 6 | Perdorur gjate vitit 2018 nga institucioni | | 264,007,376.65 | | |
| 7 | Perdorur gjate vitit 2018 nga institucionet ne mvaresi | | - | | |
| | **SHUMA E PERDORUR (5+6)** | | 264,007,376.65 | | |
| | Gjendje me 31.12.2018 per perdorim ne 2019 | | 10,984,623.35 | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |
| | | | | | |

D.SH.UNIVERSITARE
Marianthi XHA

ADMINISTRATOR
Gentian LLOGO

Per Degen e Thesarit
Specialiste e Shpenzimeve
Lumturi Qirjaqi

REPUBLIKA E SHQIPERISE -- UNIVERSITETI "EQREM CABEJ" -- GJIROKASTER

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ"

GJIROKASTËR

**ADMINISTRATORI**

Nr. 32/3 Prot.

Gjirokastër, më 12/01/2018

Lënda : Raporti Vjetor Financiar për vitin 2017

DREJTUAR: REKTORATIT

SENATIT AKADEMIK

BORDIT TË ADMINISTRIMIT

KËTU

Në zbatim të ligjit nr.9936, datë 26.06.2008 "*Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë* ", të Ligjit Nr.80/2015 datë 22.07.2015, "*Për arsimin e Lartë dhe kërkimin shkencor në institucionet e arsimit të lartë në Republikën e Shqipërisë*" neni 32, të Udhëzimit nr.2, datë 06.02.2012 "*Për proçedurat standarte të zbatimit të buxhetit*", gjendjes reale të zbatimit të buxhetit, konform miratimeve, pranë Bordit të Administrimit të Universitetit "Eqrem Cabej" , konfirmuar dhe nga Dega e Thesarit Gjirokastër, është pregatitur për miratim "Raporti Vjetor Financiar për vitin 2017" për veprimtarinë financiare të institucionit si më poshtë:

## BURIMET E FINANCIMIT TË UNIVERSITETIT "EQREM CABEJ"

## DHE

## MENAXHIMI I FONDEVE TË VITIT 2017

**Për vitin 2017 financimi nga Buxheti i shtetit** në formën e trasfertës së pakushtëzuar ishte në vlerën 274.953.104 lekë, e cila e ndarë sipas zërave të shpenzimeve jepet në tabelën e mëposhtme:

| Nr. | Emërtesa | Plani<br>Viti 2017 | Realizimi<br>Viti 2017 | % e Realizimit me planin fillestar |
|---|---|---|---|---|
| | | Trasferta pakushtezuar | Trasferta pakushtezuar | |
| 1 | Fondi i pagave | 212.887.104 | 192.153.817 | 90% |
| 2 | Sigurime shoqerore | 31.570.000 | 29.852.453 | 95% |
| 3 | Shpenzime operative | 22.496.000 | 21.984.090 | 98% |
| 4 | Bursa | 8.000.000 | 7.081.725 | 89% |
| 5 | Investime | 0 | 0 | 0 |
| | Gjithsej shpenzime | 274.953.104 | 251.072.085 | 91% |

Financimi nga Buxheti i Shtetit është akorduar në zërin e :

pagave

kontribute të sigurimeve shoqërore

shpenzime operative

bursa

REPUBLIKA E SHQIPERISE - UNIVERSITETI "EQREM CABEJ" - GJIROKASTER

Nga buxheti i vitit 2017 është realizuar pagesa e pagave të punonjësve akademikë dhe administrativ, sipas strukturës organike të miratuar për këtë vit. Ky fond është realizuar në masën 90%.

Nga Trasferta e pakushtëzuar e akorduar për 2017 është përballuar gjithashtu edhe pagesa e kontributeve të sigurimeve shoqërore e shëndetësore nga punëdhënësi në masen 95% për pjesën prej 16.7%.

Trasferta e pakushtëzuar e akorduar për vitin 2017, ka qënë në limitin që na lejoi të përballonim pagesat e planifikuara për shpenzime në fillim të vitit, duke përballuar edhe zërin e shpenzimeve operative .

Sic shihet edhe nga tabela, realizimi i trasfertës së pakushtëzuar në përqindje është i lartë dhe në vlerë absolute ka fond të papërdorur si për pagat edhe për sigurimet shoqërore në vlerë të vogël për arsye se në muajin tetor 2017 na u akordua shtesë fondi në vlerën 14.457.104 lekë.

Nga fondi i pagave gjatë vitit janë dhënë shpërblime për rast fatkeqësie e sëmundje në vlerën prej 754.638 lekë si edhe për dalje në pension duke alokuar fondet nga pagat tek pagesa për raste të vecanta.

Për zërin e shpenzimeve operative në vitin 2017 është planikuar një vlerë prej 22.496.000 lekë nga Buxheti i Shtetit .

**PËR VITIN 2017, FINANCIMI NGA TË ARDHURAT DYTËSORE**

**KRIJIMI I TË ARDHURAVE DYTËSORE PËR UNIVERSITETIN**

**"EQREM CABEJ" GJIROKASTËR ËSHTË SI MË POSHTË :**

| Nr | Lloji i të ardhurave | Viti 2017 |
|---|---|---|
| 1 | *Qera* | *96.000* |
| 2 | *Tarifa Shkollimi* | *45.063.583* |

REPUBLIKA E SHQIPERISE - UNIVERSITETI "EQREM CABEJ" GJIROKASTER

| | | |
|---|---|---|
| 3 | *Fotokopje e vërtetime e te tjera* | *629.585* |
| 4 | *Tarife regjistrimi e te tjera (kredite te pashlyera)* | *3.899.657* |
| | ***SHUMA*** | ***49.688.825*** |

Sic shihet edhe nga tabela e mësipërme për vitin 2017, të ardhurat janë realizuar në vlerën 49.688.825 lek gjithsej, nivel ky më i ulëti në këto vitet e fundit.

Duke analizuar të ardhurat e realizuara të Universitetit gjatë viteve të fundit ato janë ulur, në një masë të konsiderueshme, pavarësisht nga hapja e programeve të studimit "Master Profesional" dhe "Master Shkencor", sepse pothuajse në të gjitha programet e studimit të Universitetit, numri i studentëve të regjistruar ka ardhur në ulje. Ulja e ndjeshme e të ardhurave vjen si pasojë edhe e faktit që një pjesë e tarifës së shkollimit të studentëve është arkëtuar që në muajt nëntor–dhjetor 2016, sepse ishte përcaktuar me V.K.M. arkëtimi i 30% të tarifës së shkollimit të studentëve që në momentin e regjistrimit.

Një pjesë e konsiderueshme e të ardhurave vjen nga arkëtimi i tarifës së provimeve të prapambetura nga studentët e Masterit Profesional dhe Shkencor, të cilët nuk mbarojnë studimet brenda afatit kohor të përcaktuar në legjislacion (1.5 vjet ose 2 vjet) dhe paguajnë për cdo provim sipas krediteve përkatëse.Kjo vlerë krijon një masë të qëndrueshme të përvitshme në nivelin e të ardhurave, kurse sistemi part-time është tkurrur totalisht dhe të ardhurat e realizuara nga ky program studimi për vitin 2017 ishin minimale.

Një faktor i cili ndikon negativisht në rritjen e të ardhurave është trajtimi i një numri të madh studentësh , të cilët vijnë nga shtresa sociale në nevojë, me prindër invalid ose të përndjekur politik etj dhe nuk e paguajnë ose e paguajnë pjesërisht tarifën e shkollimit sipas sistemit të studimit përkatës.

Në tre vitet e fundit realizimi i të ardhurave është si më poshtë:

Viti 2015: 66.753.400 lek

Viti 2016 62.799.799 lek

Viti 2017 49.688.000 lekë

REPUBLIKA E SHQIPERISE - UNIVERSITETI "EQREM CABEJ" - GJIROKASTER

Ulja e numrit të studentëve si edhe përjashtimi nga pagesa për një pjesë të konsiderueshme të tyre ndikon drejtpërdrejt në uljen e të ardhurave në vitet e fundit e sidomos në vitin 2017.pasi numri i studentëve nga 1891 që ishte për vitin akademik 2014-2015 e 1615 për vitin akademik 2015-2016 , në vitin akademik 2016-2017 kemi 1227 studentë, pra një ulje prej 388 studentë që ndikon drejtpërdrejtë në realizimin e të ardhurave.

Në vitin 2017 realizimi i të ardhurave është në masën 49.688.825 lekë

Nga viti 2016 janë trashëguar 65.615.433 lekë të ardhura

Gjatë vitit 2017 janë përdorur 24.669.040 lekë të ardhura

Për vitin 2018 ngelen për tu trashëguar 90.635.218 lekë të ardhura .

**<u>Për vitin 2017, financimi nga të Ardhurat dytësore sipas zërave është:</u>**

| Nr. | Emërtesa e shpenzimeve | Viti 2017 | | |
|---|---|---|---|---|
| | | Limiti i përdorimit | Realizimi | % e Realizimit me planin fillestar |
| 1 | Fondi i pagave | 20.000.000 | 16.354.026 | 82 % |
| 2 | Shpenzime Operative | 20.704.000 | 7.469.872 | 36 % |
| 3 | Investime | 12.318.400 | 646.800 | 5 % |
| 4 | Studime projektime | 2.961.600 | 198.342 | 6 % |
| | Shuma | 55.984.000 | 24.669.040 | 44% |

Plani i limitit të përdorimit nga të ardhurat dytësore për vitin 2017 në total është 55.984.000 lekë, nga i cili është realizuar në vlerën 24.669.040 lekë, përfshirë ndryshimet e herëpasherëshme (të cilat janë miratuar rast pas rasti nga Bordi i Administrimit) ku të detajuar sipas artikujve të shpenzimeve i analizojmë më poshtë:

REPUBLIKA E SHQIPERISE - UNIVERSITETI "EQREM CABEJ" GJIROKASTER

**I- Financimi nga të ardhurat dytësore në zërin e pagave** ka përfshirë pagesën e orëve të pedagogëve të ftuar, orët jashtë kohës normale të punës, orët suplementare deri në 30 %. Me fondin e mësipërm të pagave janë mbuluar të gjitha shpenzimet sipas shkresave të ardhura nga Dekanatet dhe Departamentet për të gjithë punonjësit efektiv dhe ata të jashtëm për vitin 2017.Ka një mosrealizim tek ky zë, pasi në fondin e planifikuar në fillim të vitit është planifikuar të likuidohen edhe orët e realizuara mbi 30% të ngarkesës mësimore, por me miratimin e tyre në senat dhe në Bordin e Administrimit këto orë janë paguar nga buxheti i shtetit dhe jo nga të ardhurat e Institucionit, bazuar edhe në shkresën e Ministrisë së Arsimit dhe Sportit.

**II-Financimi nga të ardhurat dytësore për shpenzimet operative:**

Fondi për shpenzimet operative është planifikuar nga të ardhurat e institucionit në masën 20.704.000 lekë lekë në total, ku gjatë vitit janë bërë rialokime të ndryshme, brenda limitit të përdorimit të të ardhurave të miratuara në fillim të vitit, të cilat janë miratuar në BA-në e Universitetit dhe të detajuara jepen në Regjistrin e Realizimit të Prokurimeve Publike.

Brenda limitit të celur në fillim të vitit, duke pare realizimin e pritshëm të shpenzimeve janë bërë rialokimet përkatëse kryesisht për ato zëra të cilat nuk kishte planifikim paraprak dhe nuk kishim ndonjë kërkesë në fillim të vitit.

Të gjitha këto rialokime janë dërguar për miratim në BA-në dhe janë miratuar me vendimet përkatëse, duke i pasqyruar në Regjistrin e Parashikimeve Publike, të ndryshuar, ku janë njoftuar edhe Zyra e Prokurimeve pranë MAS-it edhe Dega e Thesarit Gjirokastër.

Shpenzimet sipas zërave të detajuara janë dhënë tek tabela e Regjistrit të Realizimit të Prokurimeve. Në tabelë është dhënë planifikimi dhe realizimi sipas zërave me gjithë ndryshimet përkatëse të miratuara gjatë vitit nga Bordi i Administrimit.

Nga zëri i shpenzimeve operative u financuan shpenzimet për kontratat e prokuruara dhe për shpenzimet me blerje të vogël, ku për arsye se janë planifikuar nga të ardhurat e institucionit, i është dhënë një rëndësi të vecantë efektivitetit të tyre, me qëllim realizimin e shpenzimeve më të domosdoshme për të mbajtur një rezervë që është e trashëgueshme për vitin në vazhdim.

REPUBLIKA E SHQIPERISE - UNIVERSITETI "EQREM CABEJ" GJIROKASTËR

Realizimi i shpenzimeve operative është në vlerën afërsisht 44 % nga të ardhurat .

Më poshtë japim të detajuar sipas zërave shpenzimet si nga buxheti ashtu edhe nga të ardhurat në tabelën e realizimit të shpenzimeve si më poshtë:

| | Objekti i Prokurimit | Fondi limit i parashikuar(grant e të ardhurat) | Vlera e prokuruar |
|---|---|---|---|
| 1 | Roje civile(kontrate shtese) | 907.000 | 907.000 |
| 2 | Roje civile | 4.789.000 | 4.787.997 |
| 3 | Karburant | 4.000.000 | 3.999.936 |
| 4 | Kanceleri ,boje,fotokopje,printeri etj. | 200.000 | 76.080 |
| 5 | Kanceleri, shtypeshkrime, bojra | 2.500,000 | 2.152.644 |
| 6 | Materiale pastrimi | 300.000 | 202.314 |
| 7 | Shërbime kompjuterike | 200.000 | 82.800 |
| 8 | Mirembajtje fotokopjuesi | 200.000 | 142.680 |
| 9 | Materiale elektrike, hidraul, ndertimi | 400.000 | 238.680 |
| 10 | Te tjera materiale zyre, | 500.000 | 134.468 |
| 11 | Energji | 2.300.000 | 2.330.219 |
| 12 | Ujë | 900,000 | 822.222 |
| 13 | Telefon | 1.200.000 | 670.699 |
| 14 | Sherbim postar | 200.000 | 132.768 |

REPUBLIKA E SHQIPERISE - UNIVERSITETI "EQREM CABEJ" GJIROKASTER

| | | | |
|---|---|---|---|
| 15 | Sherbime te ndryshme | 550.000 | 368.014 |
| 16 | Mirembajtje mjet transporti (dy mjete) | 1,000,000 | 934.200 |
| 17 | Materiale dhe sherbime specifike | 750.000 | 591.777 |
| 18 | Kuota e sigurimit te mjeteve | 300,000 | 128.512 |
| 19 | Sherbime Interneti, | 240.000 | 122.303 |
| 20 | Miremb te aparateve kondisiner | 300.000 | 247.560 |
| 21 | Kosto reklam.dhe publik. +buletin | 600,000 | 138.663 |
| 22 | Kosto legale( abonime etj.miremb kontrate) | 300,000 | 108,000 |
| 23 | Kosto te seanc bordeve ,mbledh senati | 2.500.000 | 2.560.959 |
| 24 | Dieta, brenda ,jashte, ekspedita | 4.700,000 | 3.438.199 |
| 25 | Sherbime te printimit dhe publikimit | 700,000 | 0 |
| 26 | Mirembajtje e godinave | 4.800,000 | 291.660 |
| 27 | Shpenzime pritje e percjellje | 500,000 | 456.670 |
| 28 | Shpenzime për konferenca kombetare apo veprimtari lokale | 450,000 | 36.000 |
| 29 | Aktivitete shkencore departamente | 460,000 | 42.000 |
| 30 | Konf.Ndërkomb.shkencore | 2.304,000 | 727.378 |
| 31 | Projekt shkencor Ekonomiku | 200.000 | |
| 32 | Mirëmb. riparime Laboratori i gjuhëve të huaja | 400.000 | |
| 33 | Mirëmbajtje sistemi i infor.dhe sistemi alarmit | 300.000 | 250.800 |

REPUBLIKA E SHQIPERISE - UNIVERSITETI "EQREM CABEJ" GJIROKASTER

| | | | |
|---|---|---|---|
| 34 | Shpenzime per Qeverine studentore | 800.000 | 714.660 |
| 35 | Taksë antaresim ne organizata universitare 605 | 850.000 | 488.090 |
| 36 | Shpenzime për akreditimin | 1.600.000 | 1.128.000 |
| | **Totali i shpenzimeve operative** | **43.200.000** | **29.453.962** |

Sic shihet nga Regjistri i Realizimit të Shpenzimeve, në përgjithësi ka zëra me mosrealizime, që kryesisht janë nga mosplanifikimi i saktë i fondit të tyre që në fillim të vitit.Për këtë arsye kërkohet nga Departamentet që në të ardhmen kërkesat e tyre te jenë të mirëstudiuara dhe reale.

Kemi një realizim të konsiderueshëm tek zërat e shpenzimeve të Telefonit dhe Energjisë, ku vitet e tjera kemi patur më shumë shpenzime dhe prandaj është planifikuar më shumë në fillim të vitit.Gjatë vitit 2017 është hequr totalisht furnizimi me energji elektrike të objektit të Ish-Shtëpisë së Ushtarakëve, ambienteve të dhëna me qera u është kërkuar lidhja e kontratës së furnizimit me energji të bëhet nga vetë qeramarrësit, si dhe janë ulur në vlerë të konsiderueshme shpenzimet si ato telefonike statike në zyrat e universitetit ashtu edhe të shpenzimeve të telefonisë celulare.Në lidhje me furnizimin e institucionit me ujë, është bërë instalimi i matësit të ujit, duke minimizuar faturën mujore të këtij shërbimi.

Në zërat e tjerë ka mos realizime pjesore për arsye të vlerave të ulëta gjatë prokurimit, por që janë bërë rialokimet e tyre në zërat ku kishim më shumë nevojë. Për arsye se të gjitha shpenzimet për funksionimin e institucionit përballohen si nga të ardhurat dytësore të Universitetit ashtu edhe nga granti, ishin planifikuar në vlera të ulëta sipas nevojave reale, me qëllim grumbullimin e të ardhurave dhe përdorimin e tyre për shpenzime më të domosdoshme në funksion të procesit të mësimdhënies dhe kërkimit shkencor.

Një mosrealizim i konsiderueshëm është në zërin Kosto reklamimi dhe publikime e buletine,pasi nga Fakultetet nuk u paraqit asnjë material për botimin e ndonjë buletini "Kërkime Universitare", nga katër të planifikuar cdo vit buxhetor të mëparshëm.

Mosrealizim kemi edhe në zërat Shpenzime për Konferencat, Aktivitete Shkencore të Departamenteve , duke përmendur zhvillimin e 2(dy) konferencave ndërkombëtare,një aktivitet për Profesorin Thoma Dhima si edhe për Akademikun Jorgo Bulo, pavarësisht se ishte e

REPUBLIKA E SHQIPERISE - UNIVERSITETI "EQREM CABEJ" - GJIROKASTER

planifikuar cdo kërkesë e Departamenteve për zhvillimin e konferencave apo aktiviteteve të tjera.

**III- Financimi për Investime dhe Studime Projektime.**

**a)Në zërin e investimeve kemi një realizim prej 5.3 %** të të ardhurave të parashikuara. Kjo ka ardhur si rezultat i realizimit të prokurimeve në një vlerë më të ulët se ajo e planifikuar nga specialistët tanë.Për vitin 2017 ka mosrealizim edhe për shkak të anullimit të procedurave të prokurimeve publike për nj periudhë si dhe për arsye të anullimit të 2(dy) prokurimeve.

Por objektet e tjera , të cilat janë janë miratuar gjatë vitit 2017 në BA-në e Universitetit dhe nuk i kemi realizuar, kemi menduar ti realizojmë në vazhdim.

**b)Në zërin Studime Projektime kemi realizim prej 6.7 %,** ku është bërë planifikimi për pagesën prej 40% e projektit të objektit "Rishikimi i projektit të shtëpisë së Ushtarakëve", pasi një pjesë e saj u kalua në administrim të Adisë-s dhe sipas legjislacionit në fuqi mund të bëhet rishikim projekti në masën 40% të projektit fillestar.Por duke qënë se zëri studime projektime është i lidhur me zërin investime rrjedhimisht edhe ky zë është realizuar në këtë masë kaq të ulët.

**STUDIME PROJEKTIME DHE INVESTIME**

| | **Studime projektime e investime** | **Planifikuar** | **Realizuar** |
|---|---|---|---|
| 1 | Studime projektime leje ndertimi | 561.600 | 198.342 |
| 2 | Supervizion kolaudim | 218.400 | |
| | Rishikim i projektit të shtëpisë së ushtarakeve | 2.400.000 | |
| 3 | Rikonstruksion i nyjeve hidro sanitare | 6.500.000 | |
| 4 | Paisje kompjuterike e elektrike | 2.000.000 | |
| 5 | Paisje zyre mobileri | 800.000 | 646.800 |
| 6 | Mjete didaktike harta lab.gjeografise | 800.000 | |
| 7 | Libra per bibliotekën | 2.000.000 | |
| | **Totali** | **15.280.000** | **845.142** |

REPUBLIKA E SHQIPERISE · UNIVERSITETI "EQREM CABEJ" · GJIROKASTER

Bashkëngjitur keni Evidencën e Realizimit të shpenzimeve Janar- Dhjetor 2017, Evidencën e Realizimit të të Ardhurave, të konfirmuar edhe nga Dega e Thesarit Gjirokastër.

**ADMINISTRATOR**

**Gentian LLOGO**

**Konceptoi**

**Marianthi XHA**

REPUBLIKA E SHQIPERISE - UNIVERSITETI "EQREM ÇABEJ" - GJIROKASTER